



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANË

NR. AKTI 327

NR. VENDIMI 984



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR

TIRANË

Nr. 327 Regj.Them.

Nr.984

Vendimi

Datë e Regjistrimit 27/07/2020

Data e

Vendimit 12/04/2021

V E N D I M

"NE EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë nga

GJYQATAR : ARDIAN KALIA

asistuar nga sekretare gjyqësore Beglije NURO, në seancë gjyqësore me dver te hapura, sot me dt.12/04/2021, përfundoi shqyrtimin e çështjes penale, e cila i përket:

Akuzues: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë
përfaqësuar nga Prokuror ***.

KUNDËR

Të Pandehurve: 1. *** , i biri *** dhe i *** , i datëlindjes *** lindur në *** dhe banues në *** , me shtetësi shqiptare, i martuar, i padënuar më parë, me arsim të lartë, në mungesë, i përfaqësuar në gjykim me mbrojtës zgjedhur Av. *** , me Nr. *** licence dhe NIPT *** , Anëtar i Dhomës së Avokatëve ***.

2. *** , i biri *** dhe i *** , i datëlindjes *** , lindur në *** dhe banues në *** , me shtetësi shqiptare, beqar, i padënuar më parë, me arsim të lartë, në mungesë, i përfaqësuar në gjykim me mbrojtës zgjedhur Av. *** , me Nr. *** licence dhe NIPT *** , Anëtar i Dhomës së Avokatëve ***.

Akuzuar : Për kryerjen e veprës penale “Shkelje e të drejtave të Pronësisë industriale”, kryer në bashkëpunim , të parashikuar nga neni 149/a/2 i Kodit Penal.

Viktimë: Shoqëria “***” , e përfaqësuar në gjykim nga administratori Z. ***.

Gjykata, pasi pranoi kërkesën e te pandehurit dhe vijoi gjykimin me procedurë të

gjykimi të shkurtuar, në përfundim dëgjoi palët në diskutimin përfundimtar, të cilët kërkuan respektivisht:

Prokuroria: “Deklarimin fajtor të pandehurit *** , akuzuar për kraverjen e veprës penale “Shkelje e të drejtave të Pronësisë industriale” kryer në bashkëpunim dhe në bazë të nenit 149/a/2 të Kodit Penal, dënimin e tij me *** lekë gjobë;

Deklarimin fajtor të pandehurit *** , akuzuar për kraverjen e veprës penale “Shkelje e të drejtave të Pronësisë industriale” kryer në bashkëpunim dhe në bazë të nenit 149/a/2 të Kodit Penal, dënimin e tij me *** lekë gjobë”.

Mbrojtësi i të pandehurve *** e ***: “Pushimin e çështjes ne ngarkim te te pandehurit *** ndërsa, sa i përket te pandehurit *** , kërkoj pezullimin e çështjes penale, ose pafajësi”.

Përfaqësuesi i viktimës: “Shpalljen fajtor dhe denimin e shtetasve *** dhe *** , per kraverjen e vepres penale “Shkelja e te drejtave te pronesise industrial”, ne bashkepunim parashikuar nga nenet 149/a dhe 25 i K.Penal. Heqjen e se drejtes se ushtrimit te veprimtarise tregtare duke perdorur marken *** e ***. Detyrimin e publikimit ne media te vendimit te gjykates sipas nenit 30 te K.Penal”.

Gjykata pasi analizoi çështjen në tërësi:

V E R E N

Se organi i Prokurorisë pranë Gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë ka vënë në lëvizje Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me anën e kërkesës për gjykimin e të pandehurit *** , duke e akuzuar se ka kryer veprën penale “Shkelje e të drejtave të Pronësisë industriale”, kryer në bashkëpunim , të parashikuar nga neni 149/a/2 të Kodit Penal.

Nga ana e palëve në proces nuk pati pretendime lidhur me kompetencën apo juridiksionin e Gjykatës si edhe vetë Gjykata nuk konstatoi kravesisht shkaqe papajtuesmerie për gjykimin e kësaj çështjeje. Për shkak të masës së dënimit të parashikuar posaçërisht nga dispozita e ligjit material penal (neni 149/a/2 të Kodit Penal) për të cilën akuzohen të pandehurit, në kuptim të nenit 13 të K.Pr.Penale, gjykimi i kësaj çështjeje u zhvillua nga një gjyqtar.

Nga ana e mbrojtësit të të pandehurve, para fillimit të shqyrtimit gjyqësor, u kërkuua që të procedohej nga Gjykata me procedurë gjykimi të shkurtuar, për të cilën përfaqësuesi i organit të akuzës, Prokurorisë së rrethit gjyqësor Tiranë, u shpreh se ishte dakort. Gjykata pasi shqyrtoi aktet e përfshira në fashikullin e hetimeve paraprake, pasi shqyrtoi edhe tagrat e përfaqësimit të deleguara me prokurë, mbrojtësit të zgjedhur nga ana e të pandehurit, midis të cilave edhe e drejta për të kërkuar gjykim të shkurtuar, krijoi bindjen se çështja mund të zgjidhej në gjendjen që janë aktet, ndaj disponoi me vendim për pranimin e kërkesës së të pandehurve dhe të procedojë me gjykim të shkurtuar, nga i cili rezultoi se:

Shoqëria “*** viktimë për efekt të këtij procedimi penal, operon në tregun shqiptar prej disa vitesh. Ortakët e kësaj shoqërie prej vitit 1998 kanë përdorur logon *** fillimisht pranë *** , prej edhe nga ka lindur ideja e kësaj marke tregtare dhe më pas prej vitit 2000 tek *** , duke pasur në përdorim dhe pronësi këtë marke prej 15 vitesh

dhe duke u identifikuar me këtë markë tregtare.

Në vitin 2012, me kontratën Nr. *** lokalit e tyre që ndodhet në *** e ka marrë me gera shtetësja *** bashkëshortja e *** dhe ky i fundit. Kontrata është lidhur më datë *** me afat deri me datë ***. Ndërkohë shtetasi *** nëpërmjet lidhjeve të tij familjare me *** (babai i ***), kanë hapur 4 lokale në Tiranë me të njëjtin emër “***”, në pika të ndryshme të Tiranës duke krijuar një rrjet lokalesh me këtë emër.

Nga aktet e administruara në këtë gjykim si provë rezulton se, Shoqëria *** që nga data 09.12.2015 është pronar i markës tregtare “***”, me numër regjistrimi kombëtar *** me datë regjistrimi ***, me të drejta të plota dhe në përputhje të plotë me ligjin. Pas regjistrimit të markës shoqëria *** me datë *** njofton shtetasit *** dhe *** që të ndalojnë përdorimin e markës “***” në pronësi tashmë të firmës ***.

Sipas komunikimeve me shoqërinë “***” sh.p.k, shtetasi *** ka deklaruar se është pronar de fakti i të tre lokaleve dhe i ka kërkuar një afat deri me datë *** për të hequr emrin. Kur asnjëri prej personave që kishin marrë njoftim nuk kanë reaguuar shoqëria “***” sh.p.k, i është drejtuar me kërkesë padi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë depozituar me datë ***. Nga vërtetimi i lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë datë 23.02.2017 rezulton se pranë kësaj gjykatë është regjistruar për gjykim çështja civile me nr. *** Akti datë ***, me paditës shoqëria “***” sh.p.k dhe të paditur ***, *** me objekt konstatimin e përdorimit të pautorizuar të markës tregtare “***”.

Në vijim, emri i “***” rezulton të jetë përdorur në një lokal edhe nga i pandehuri ***, i cili ka qenë në bashkëpunim për krverjen e veprimeve me të pandehurin ***.

Nga aktet shkresore pjesë e fashikuve të hetimeve paraprake të këtij procedimi penal, rezulton se, më herët, ky procedimi penal në ngarkim të të pandehurve *** e ***, është dërguar për Gjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me vendim nr. *** rregj datë ***, kjo Gjykatë ka vendosur: “Pushimin e gjykimit të çështjes penale nr. *** Akti datë *** në ngarkim të të pandehurve *** dhe ***, akuzuar për veprën penale “Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale”, të parashikuar nga neni 149/a/2 i Kodit Penal”. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim Prokurori dhe Gjykata e Apelit Tiranë, me vendim nr. ***, datë *** ka vendosur: “Ndryshimin e vendimit nr. *** rregj datë *** te Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe kthimin e akteve prokurorit për vazhdimin e hetimeve në lidhje me procedimin penal nr. ***, të vitit ***.

Në lidhje me faktet e cituara më lart, nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë u pretendua se, rezulton plotësisht e provuar se të pandehurit *** dhe ***, kanë kryer veprën penale “Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale” në bashkëpunim të parashikuar nga neni 149/a i Kodit Penal, në dëm të viktimës.

Fakti i cili i atribuohet si vepër penale të pandehurve *** dhe ***, rezultoi i provuar me aktet e paraqitura nga organi i prokurorisë, të cilat për shkak të gjykimit me procedurë të shkurtuar marrin vlerën e provës në gjykim (qëndrim i cili është mbajtur edhe nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin Unifikues Nr. 2 datë 29.01.2003) dhe më konkretisht:

Certifikatë Regjistrimi i Markes “***”, numër regjistrimi kombëtar *** me datë

regjistrimi ***.

Ekstrakt QKR i Shoqërisë “****

Ekstrakt QKR i subjektit ***.

Vendim nr. *** Regj.Themeltar, datë ***, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Vendim nr. ***, datë ***i Gjykatës së Apelit Tiranë.

Vendim nr. *** Regj.Themeltar, datë ***i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Vendim nr. ***, datë ***i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në tërësi aktet e tjera provuese, pjesë e fashikullit të hetimeve paraprake të procedimit penal Nr. ***, të vitit ***.

Nga ana e tij, mbrojtësi i të pandehurve *** e ***, kundërshtoi akuzën e ngritur ndaj të dy të pandehurve si të pambështetura ligjërisht. (Shih konkluzionet përfundimtare të paraqitura nga ana e mbrojtjes së të pandehurve). Në përfundim, mbrojtësi i të pandehurve kërkoi: “Pushimin e çështjes ne ngarkim te te pandehurit *** ndërsa, sa i përket te pandehurit ***, kërkoi pezullimin e çështjes penale, ose pafajësi”.

Në përfundim, në analizë të akteve shkresore provuese të administruara në gjykim, në analizë të deklarimeve të dhëna nga ana e shtetasit ***, në interpretim të kuadrit ligjor material penal i cili parashikon veprat penale kundër pasurisë dhe ekonomisë (Kreu III Seksioni II i Kodit Penal) Gjykata krijon bindjen e plotë të brendshme se, nga ana e te pandehurve *** e *** janë konsumuar tërësisht elementët e figurës së veprës penale “Shkelje e të drejtave të Pronësisë industriale”, kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 149/a/2 i Kodit Penal dhe ata duhet të deklarohen fajtorë për sa akuzohen.

Fajësia e të pandehurve *** e *** si autorë të veprës penale për të cilën akuzohen, u provua përtej çdo dyshimi të arsyeshëm me provat e cituara si me sipër dhe në tërësi me aktet shkresore provuese të paraqitura nga ana e organit të akuzës, pjesë e fashikullit penal Nr *** i vitit ***.

Përsa i përket kualifikimit ligjor të fakteve objekt akuze, të parashtruara më lart, Gjykata vëren se, neni 149/a i K.Penal parashikon: “Prodhimi, shpërndarja, mbajtja për qëllime tregtimi, shitja, ofrimi për shitje, furnizimi, shpërndarja, eksportimi ose importimi për këto qëllime i: a) produktit ose procesit të mbrojtur nga një patentë, pa pëlqimin e pronarit të patentës; b) produktit që mbrohet nga një dizenjo industriale, pa pëlqimin e pronarit të dizenjës industriale; c) mallrave ose shërbimeve që mbrohen nga një markë tregtare, pa pëlqimin e pronarit të markës tregtare; ç) produktit që rrjedh nga një tregues gjeografik, pa pëlqimin e pronarit të treguesit gjeografik; 53 të kryera me dashje, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë ose me burgim gjer në një vit.

Po kjo vepër kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet”.

Konkretisht persa i përket objektit të figurës së veprës penale për të cilën akuzohen, të pandehurit *** e *** me veprimet e tyre te kundërligjshme kanë cënuar ato marrëdhënie juridike të vendosura me ligj për te garantuar, mbarëvajtjen e ekonomisë dhe qarkullimit civil në përgjithësi, marrëdhënie këto të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni material penal. Nga ana objektive, rezultojnë e provuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm nga aktet shkresore provuese të përfshira në fashikujt e hetimeve paraprake se, të pandehurit *** e *** e kanë kryer veprën penale me veprime të kundërligjshme që konsistojnë në, përdorimin pa të drejtë të një marke të

mbrojtur, e cila i përket subjektit të dëmtuar, viktimë për efekt të këtij procedimi penal.

Nga ana subjektive, kjo vepër penale është kryer nga të pandehurit *** e *** me dashje direkte. Subjekti i kësaj figure vepre penale janë të pandehurit *** e ***, për të cilët rezultoi të kenë mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe nuk verifikohet prania e ndonjë shkakut që t'i privojë nga përgjegjësia penale, pra janë të përgjegjshëm para ligjit penal.

Fajësia e të pandehurve në kryerjen e kësaj vepre penale rezultoi e provuar nga të gjitha provat e sipërcituara të paraqitura nga përfaqësuesi i Akuzës, të administruara nga Gjykata në seancë gjyqësore. Gjykata, krijoi bindjen se të pandehurit *** e ***, janë subjekti i kryerjes së veprës penale “Shkelje e të drejtave të Pronësisë industriale”, kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 149/a/2 të Kodit Penal pasi, me veprimet e tyre të kundërligjshme ka shkelur përcaktimet e dispozitës penale të sipërcituar, ngarkohen me përgjegjësi penale dhe duhet të përgjigjen penalisht sipas sanksioneve të kësaj dispozite të Kodit Penal.

Gjykata i gjen të pambështetur ligjërish e në prova pretendimet e mbrojtësit të zgjedhur të të pandehurve *** e ***, si për pushimin çështjes penale, ashtu edhe për pezullimin apo pafajësinë e tyre. Në një konkluzion të tillë, Gjykata arrin duke iu referuar tërësisë së provave shkresore të marra në këtë gjykim, nga analiza e të cilave, Gjykata konkludoi se, u vërtetua përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se të pandehurit e kanë kryer veprën penale “Shkelje e të drejtave të Pronësisë industriale”, kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 149/a/2 të Kodit Penal.

Lidhur me llojin dhe masën e dënimit që duhet të caktohet për të pandehurit *** e ***, Gjykata merr në konsideratë rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale për të cilën akuzohen të pandehurit, marzhin e dënimit me gjobë ose, burgim deri në 2 vjet, që parashikon dispozita e ligjit material penal për të cilën akuzohen të pandehurit. Gjykata merr në konsideratë gjithashtu edhe rrezikshmërinë e pakët të të pandehurve, për të cilët nuk rezultoi të jenë të dënuar më parë penalisht, faktin se kjo vepër penale është kryer në bashkëpunim si dhe dënimin që i është shkaktuar viktimës Shoqërisë ***.

Mbështetur në sa më sipër, Gjykata konkludoi se lloji i dënimit me gjobë i kërkuar nga organi i akuzës është ligjërish e bazuar në dispozitën përkatëse penale Nenin 149/a/2 të Kodit Penal, ndërsa si masë dënimi, çmon t'i caktojë secilit prej të pandehurve, ***lekë gjobë, duke e ulur me 1/3 këtë masë dënimi, në bazë të nenit 406 të K.Pr.Penale, për shkak të procedimit me gjykim të shkurtuar.

Gjykata vlerëson se, masa e dënimit me ***lekë gjobë ndaj secilit prej të pandehurve, i përgjigjet shkallës së rëndësisë së faktit, veprës penale të kryer nga të pandehurit *** e ***, por edhe rrethanave të mësipërme të çështjes të cilat, të çmuara në kompleksitet, e justifikojnë ligjërish këtë lloj e masë dënimi penal. Gjykata vlerëson se, aplikimi i një mase të tillë dënimi me gjobë ndaj të pandehurve i përgjigjet më drejt shkallës së rrezikshmërisë së të pandehurve, të veprës penale të kryer prej tyre, përmbush qëllimet e dënimit penal në lidhje me ndëshkimin, riedukimin e të pandehurve si dhe efektin parandalues ndaj shoqërisë në përgjithësi.

Gjykata, duke respektuar natyrën e veprës penale të shkaktuar në dëm të viktimës Shoqërisë “***, çmon që, në bazë të nenit 30 të Kodit Penal, të caktojë një dënim plotësues ndaj të pandehurve. Më konkretisht Gjykata urdhëron që, të pandehurve ***dhe ***, t’u hiqet e drejta të ushtrojnë veprimtari tregtare duke përdorur markën tregtare “***”. Gjithashtu, bazuar në nenin 43 të Kodit Penal, Gjykata disponon që, të urdhërohen të pandehurit ***dhe ***që, me shpenzimet e tyre, të publikojnë vendimin gjyqësor, në pjesën që lidhet me dënimin plotësues të dhënë ndaj tyre në bazë të nenit 30 të Kodit Penal, duke e publikuar për një periudhë 30(tridhjetë) ditore, në dy nga mediat e shkruara me qarkullim kombëtar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, në bazë të neneve 112, 379, 384 e 390 të K.Pr.Penale

VENDOSI

Deklarimin fajtor të të pandehurit ***, për krerjen e veprës penale “Shkelje e të drejtave të Pronësisë industriale”, kryer në bashkëpunim , të parashikuar nga neni 149/a/2 i K.Penal dhe në bazë të kësaj dispozite dënimin e tij me *** lekë gjobë. Në zbatim te nenit 406/1 të K.Pr.Penale, uljen e 1/3 së këtij dënimi dhe dënimin përfundimisht të të pandehurit *** me *** lekë gjobë.

Deklarimin fajtor të të pandehurit ***, për krerjen e veprës penale “Shkelje e të drejtave të Pronësisë industriale”, kryer në bashkëpunim , të parashikuar nga neni 149/a/2 i K.Penal dhe në bazë të kësaj dispozite dënimin e tij me *** lekë gjobë. Në zbatim te nenit 406/1 të K.Pr.Penale, uljen e 1/3 së këtij dënimi dhe dënimin përfundimisht të të pandehurit ***me *** lekë gjobë.

Bazuar në nenin 30 të Kodit Penal, të pandehurve *** dhe ***, u hiqet e drejta të ushtrojnë veprimtari tregtare duke përdorur markën tregtare “***”.

Bazuar në nenin 43 të Kodit Penal, urdhërohen të pandehurit *** dhe *** që, me shpenzimet e tyre, të publikojnë këtë vendim gjyqësor, në pjesën që lidhet me dënimin plotësues të dhënë ndaj tyre në bazë të nenit 30 të Kodit Penal, duke e publikuar për një periudhë 30(tridhjetë) ditore në dy nga mediat e shkruara me qarkullim kombëtar. Shpenzimet procedurale i ngarkohen të pandehurve solidarisht.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 15 ditëve, duke filluar ky afat, nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit.

U shpall në Tiranë sot, me dt.12/04/2021.

SEKRETARE

GJYQTAR

Beglije NURO

ARDIAN KALIA

Shpenzimet gjyqësore s/paraprake

Njoftime 600 leke

Shpenzime gjyqësore ne themel

Njoftime (10x15) - 1500 leke
Shpenzime te prokurorise - 4000 leke
